Veglat e punës

Mallë metalike, mallë plastike, rul dhe msitri. Veglat e punës duhet të pastrohen para dhe pas pune. Çdo mbetje e materialit nëpër vegla, ndikon në cilësinë e materialit dhe të punës.

Magazinimi dhe mirëmbajtja

Produkti duhet të vendoset brenda në magazinë, vend të mbuluar pa praninë e lagështirës dhe lagies nga uji. Edhe nëpër kantiere, produkti duhet të vendoset në vende të thata dhe pa praninë e lagështirës. Çdo ankesë që do të vijë në lidhje me faktorët e lartpërmendur, nuk do të merren parasysh si ankesa.

Paketimi

Thase 25kg, Paleta 54 thasë ose 1350 kg
Ngjyra – E bardhë
Skandenca – 12 muaj sipas datës së vendosur mbi thes.

weber SAINT-GOBAIN

webermin Classic

Suva / Grafiato dekorative minerale me thasë

SAINT-GOBAIN

Saint Gobain Constructio Products Albania sh.p.k
Rr. Budull Nr.3, 1039, Ahmetaq Preze, Vore, Albania
Tel.: +355 42 455 044
E-mail: sales.albania@saint-gobain.com
www.saint-gobain.al
www.weber.al

SAINT-GOBAIN

webermin Classic

Suva / Grafiato dekorative minerale me thasë

KARAKTERISTIKAT

Paketimi: Thasë 25kg, Paleta 54 thasë ose 1350 kg
Ngjyra: Gri ose e bardhë
Skandenca: 12 muaj pas datës së vendosur mbi thes.
Konsumi mesatar: 7kg/m2
Koha e tharjes: 1 mm/ditë sipas trashësisë së aplikuar

Informacion i përgjithshëm i produktit

Përshkrimi

Suva dekorative me granulë të trashë me bazë guri gëlqeror, çimento të bardhë për dekorimin e mureve të jashtme dhe të brendshme.

Përdorimi

Webermin classic përdoret për dekorimin dhe mbrojtjen e mureve/tavaneve të jashtme dhe të brendshme duke e përdorur si shtresë finale para aplikimit të ngjyrave. Disponohet në dy struktura – me gërvishtje dhe me strukturë të plotë. Produkti karakterizohet nga:

- Punueshmëri e lartë
- Ngjitje perfekte me bazamentin
- Lehtësi në aplikim dhe formimin e dekorit të fasadës
- Ruan përformancën e fasadës për një kohë të gjatë
- Perfekte mbi fasadat me lesh guri
- Përçim i avujve të ujit

Përgatitja e bazamentit

Webermin classic aplikohet mbi bazamente me bazë çimento të paratrajtuara dhe të rrafshuara paraprakisht ose mbi pllakat e gipsit të paratrajtuara me primer. Bazamenti duhet të pastrohet fillimisht nga pluhuri, lagështira, njollat a vajit apo myku që mund të krijohet në sipërfaqe. Në qoftë se nuk pastrohen mire faktorët e lartpërmendur, çdo aplikim i gabuar do të sjellë ankesa për të cilat vetë aplikuesi është përgjegjës. Aplikoni weberprim akril përpara aplikimit të webermin classic për të unifikuar sipërfaqen e bazamentit dhe të shmangim tharjen e shpejtë.

Temperaturat e aplikimit duhet të jenë mbi 5^{0}C deri në 30^{0}C dhe me lagështirë deri në 70%. Në aplikimet jashtë kufijve të lartpërmendur mund të krijohen tharje të shpejta, të ngadalta apo paraqitje e plasaritjeve që nuk janë në përgjegjësinë e prodhuesit. Mos e përdorni këtë produkt mbi sipërfaqe të drurit, plastikës apo metalit.

Përgatitja dhe aplikimi

Produkti ka një përzierje 25kg me 5.5-7.5 litra ujë, përzieni materialin në një enë të madhe me mikser elektrik, derisa të arrihet një masë e njëtrajtshme sipas udhezimeve të produktit. Aplikoni produktin me një mallë metalike mbi sipërfaqe duke e hapur dhe e lënë për 10 minuta që të mpikset. Më pas, i jepet dekori me mallë plastike sipas dëshirës në mënyrë rrethore, vertikale apo horizontale. Pas aplikimit dhe tharjes së plotë, në sipërfaqet e jashtme duhet të aplikohet bojë për fasadë weberton. Në ambientet e brendshme rekomandohet aplikimi i ngjyrave weberpolikolor.

KUJDES – *Në qoftë se gjatë aplikimit vëreni ndryshime të cilësisë së produktit, ju lutem nderprisni menjëherë punën dhe* ***njoftoni personin e kontaktit nga Saint Gobain Albania*** *ose dërgoni email në adresën:* ***sales.albania@saint-gobain.com.*** *Mos vazhdoni punën me të njëtën datë prodhimi apo numër serial të vendosur mbi thes. Ju lutem ruani numrin serial të amballazhit, datën e prodhimit, si dhe të dhënat kryesore mbi produktin.*

Tharja

Te ruhet nga ngrica gjatë tharjes për të shmangur tharjen me vonesë dhe plasaritjet. Të ruhet nga erërat dhe rrymat e ajrit për të shmangur tharjen e shpejtë dhe plasaritjet. Weber sugjeron që kur punohet në fasadë, të punohet në pozicionin përballë diellit për të shmangur tharjen e shpejtë. Nuk duhet të aplikohet produkti mbi sipërfaqe të lagura apo me lagështirë pasi japin efekt negativ në fasadë.

Konsumi - 7kg/m2 – 1mm në ditë, tharja e plotë pas 28 ditësh